



## PROCESVERBAL I PËRMBLEDHUR Seancë plenare

E hënë, datë 1 shkurt 2021, ora 10:00

*(Procesverbali i përmbledhur mbahet në mbështetje të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe përmban në mënyrë të përmbledhur punimet parlamentare në seancë plenare. Informacion më të detajuar mund të gjeni në procesverbalin e plotë i cili publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet pas miratimit).*

*(Seanca plenare, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 zhvillohet duke respektuar distancimin fizik të deputetëve dhe masat e tjera mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19)*

Ora 10:00.

Seanca plenare hapet nga Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi.  
Ftohet media të hyjë në sallë.

*(E pranishme për të ndjekur punimet është TVSH. Shërbimi u ofrohet televizioneve të tjera nëpërmjet TVSH-së)*

Kryetari i Kuvendit lexon rendin e ditës.

Fillon shqyrtimi i çështjeve.

*(Nga Kryetari i Kuvendit njoftohet mostranskriptimi i procesverbalit të seancës plenare datë 28.01.2021 për shkak të mungesës së kohës fizike nga Shërbimet e Kuvendit.)*

Ndërhyrje për procedurë nga deputeti: Kujtim Gjuzi.

*(Drejtuesi i seancës sqaron deputetin lidhur me çështjen e ngritur për procedurë.)*

Fillon çështja parë e rendit të ditës: [Interpelancë me ministrin e Shtetit për Diasporën kërkuar nga një grup deputetësh.](#)

Interpelancën e parashtron në emër të deputetëve kërkues, z. Kostaq Papa.

Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi i jep fjalën ministrit të Shtetit për Diasporën për tu shprehur në lidhje me interpelancën.

Vazhdon zhvillimi i interpelancës si vijon: fjala deputetit Kostaq Papa – ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko – deputeti Kostaq Papa.

Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi deklaron përfundimin e interpelancës.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Raport i veprimtarisë së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për vitin 2020.](#)

*(Në mbështetje të nenit 6, pika 4 të Rregullores së Brendshme të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” Kryetari dhe Zëvendëskryetari i grupit dorëzon në Kuvend dhe paraqet në seancë plenare raportin vjetor të veprimtarisë së grupit.)*

Në emër të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” shprehet deputetja Vasilika Hysi. Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi deklaron të përmbushur detyrimin për raportim.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektligj “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.](#) Ministri i Brendshëm, z. Bledar Çuçi (ministri kundërfirmues) prezanton projektligjin. Në mbështetje të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, drejtuesi i seancës deklaron të hapur diskutimin në parim të projektligjit.

*(Fjala u jepet diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar.)*

*(Drejtimin e seancës e merr Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi)*  
Marrin fjalën deputetët sipas radhës në vijim: Rudina Hajdari, Ralf Gjoni.

Ndërhyrje për procedurë nga deputetja: Rudina Hajdari.  
*(Drejtuesja e seancës sqaron deputeten lidhur me çështjen e ngritur për procedurë.)*

Vazhdojnë diskutimet e deputetëve sipas radhës në vijim: Taulant Balla.  
Ndërhyrje për replikë nga deputetja: Rudina Hajdari.  
Vazhdojnë diskutimet e deputetëve sipas radhës në vijim: Halit Valteri, Korab Lita, Ermonela Felaj, Elena Xhina, Kujtim Gjuzi.

Në përfundim të diskutimit në parim, në mbështetje të nenit 74, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, drejtuesi i seancës fton kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare për tu shprehur. Në emër të Grupit Parlamentar “Demokrat” shprehet deputeti Myslim Murrizi. Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi deklaron përfundimin e diskutimit në parim të projektligjit

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.](#) Deputeti z. Ilir Beqaj në cilësinë e nismëtarit prezanton projektligjin. Në mbështetje të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, drejtuesja e seancës deklaron të hapur diskutimin në parim të projektligjit.

*(Fjala u jepet diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar.)*

Marrin fjalën deputetët sipas radhës në vijim: Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural znj. Milva Ekonomi, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit z. Blendi Klosi, deputetët: Selami Jenishehri, Zef Shtjefni, Kostaq Papa. Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi deklaron përfundimin e diskutimit në parim të

projektligjit.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr.62/2014"](#).

Ministrja e Financës dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj (ministrja kundërfirmuese) prezanton projektligjin.

Në mbështetje të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, drejtuesja e seancës deklaron të hapur diskutimin në parim të projektligjit.

*(Fjala u jepet diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar.)*

Marrin fjalën deputetët sipas radhës në vijim: Artur Roshi, Nimet Musaj, Ervin Bushati, Zef Shtjefni, Kostaq Papa.

Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi deklaron përfundimin e diskutimit në parim të projektligjit.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit \(IPA II\)"](#).

Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme znj. Olta Xhaçka (ministrja kundërfirmuese) prezanton projektligjin.

Në mbështetje të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, drejtuesja e seancës deklaron të hapur diskutimin në parim të projektligjit.

*(Fjala u jepet diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar.)*

*(Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi)*

Marrin fjalën deputetët sipas radhës në vijim: Ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin znj. Elisa Spiropali, Erion Piciri, Vasil Sterjovski.

Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi deklaron përfundimin e diskutimit në parim të projektligjit.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr.10094, datë 12.3.2009"](#).

*(Për këtë projektligj është regjistruar deputetja Antoneta Dhima)*

Merr fjalën deputetja Antoneta Dhima.

Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi deklaron përfundimin e diskutimit në parim të projektligjit.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektvendim "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri \(ISKK\)"](#).

Në mbështetje të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, drejtuesi i seancës deklaroi të hapur diskutimin e projektvendimit.

*(Fjala u jepet diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar.)*

Marrin fjalën deputetët sipas radhës në vijim: Myslim Murrizi.

Ndërhyrje për replikë nga Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin znj. Elisa Spiropali. Kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi deklaroi përfundimin e diskutimit të projektvendimit.

Fillon çështja tjetër e rendit të ditës: [Projektvendim “Për emërimin e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”](#).

*(Për këtë projektvendim nuk ka regjistrime.)*

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën i dorëzon Kryetarit të Kuvendit rezultatet e votimit për çështjet në rendin e ditës.

Kryetari i Kuvendit shpall rezultatet si vijon:

- Projektligj “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.  
Miratohet në parim me 86 vota pro, 10 kundër dhe 6 abstenime.  
Miratohet në tërësi me 87 vota pro, 10 kundër dhe 6 abstenime.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.  
Miratohet në parim me 88 vota pro, 9 kundër dhe 6 abstenime.  
Miratohet në tërësi me 87 vota pro, 10 kundër dhe 7 abstenime.
- Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr.62/2014".  
Miratohet në parim me 97 vota pro, 5 kundër dhe 1 abstenim.  
Miratohet në tërësi me 97 vota pro, 6 kundër dhe 1 abstenim.
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)".  
Miratohet në parim me 96 vota pro, 7 kundër dhe 1 abstenim.  
Miratohet në tërësi me 95 vota pro, 7 kundër dhe 2 abstenime.
- Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr.10094, datë 12.3.2009".  
Miratohet në parim me 96 vota pro, 7 kundër dhe 1 abstenim.  
Miratohet në tërësi me 95 vota pro, 7 kundër dhe 2 abstenime.
- Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të

punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pashëve të Komunizmit në Shqipëri (ISKK)”.  
Miratohet me 88 vota pro, 9 kundër dhe 6 abstenime.

- Projektvendim “Për zgjedhjen e z. Lorenc Bako anëtarë i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”  
Miratohet me 83 vota pro, 14 kundër dhe 8 abstenime.

Merr fjalën deputeti Kujtim Gjuzi për çështje jashtë rendit të ditës (60’) si dhe për shpjegim vote kundër.

Kryetari i Kuvendit deklaron të mbyllur seancën plenare.

*(Seanca mbyllet në orën 13.30)*



Shërbimi i Seancës Plenare

# LISTA E DISKUTUESVE

(Neni 46 - 47 - 48, Rregullore Kuvendi)

**Seancë plenare, datë 1 shkurt 2021, ora 10:00**

**Interpelancë me ministrin e Shtetit për Diasporën kërkuar nga një grup deputetësh.**

<b>Nr.</b>	<b>Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “Demokrat”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “Demokraci Drejtësi”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “I pavarur”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>
1.	Pandeli Majko - <i>Ministër</i>	11’					Kostaq Papa	12’

**Raport i veprimtarisë së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për vitin 2020.**

<b>Nr.</b>	<b>Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “Demokrat”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “Demokraci Drejtësi”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “I pavarur”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>
1.	Vasilika Hysi	10’						

**Projektligj “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.**

Nr.	Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar “Demokrat”	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar “I Pavarur”	Minutazhi i konsumuar	Grupi “Demokraci Drejtësi”	Minutazhi i konsumuar	Deputetë jashtë grupeve parlamentare	Minutazhi i konsumuar
1.	Bledar Çuçi - <i>Ministër</i>	5’	Rudina Hajdari	8’	Ralf Gjoni	7’			Kujtim Gjuzi	1’
2.	Ermonela Felaj	3’	Halit Valteri	7’					Elena Xhina	1’
3.			Korab Lita	7’						

**Në emër të grupeve parlamentare**

Nr.	Emër/ Mbiemër	Grupi Parlamentar	Minutazhi i konsumuar	Pozicioni
1.	Taulant Balla	PS	10’	Kryetar i grupit
2.	Myslim Murrizi	“Demokrat”	10’	Kryetar i grupit



**Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.**

Nr.	Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar “Demokrat”	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar “I Pavarur”	Minutazhi i konsumuar	Deputetë jashtë grupeve parlamentare	Minutazhi i konsumuar
1.	Milva Ekonomi - <i>Ministër</i>	5’					Kostaq Papa	1’
2.	Blendi Klosi - <i>Ministër</i>	4’					Zef Shtjefni	1’
3.	Ilir Beqaj	6’						

**Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr.62/2014".**

Nr.	Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar “Demokrat”	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar “I Pavarur”	Minutazhi i konsumuar	Deputetë jashtë grupeve parlamentare	Minutazhi i konsumuar
1.	Anila Denaj - <i>Ministër</i>	4’	Artur Roshi	5’	Nimet Musaj	10’	Kostaq Papa	1’
2.	Ervin Bushati	5’					Zef Shtjefni	1’

**Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)".**

Nr.	Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar "Demokrat"	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar "I Pavarur"	Minutazhi i konsumuar	Deputetë jashtë grupeve parlamentare	Minutazhi i konsumuar
1.	Olta Xhaçka - <i>Ministër</i>	5'					Erion Piciri	1'
2.	Elisa Spiropali - <i>Ministër</i>	5'					Vasil Sterjovski	1'

**Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr.10094, datë 12.3.2009".**

Nr.	Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar "Demokrat"	Minutazhi i konsumuar	Grupi Parlamentar "I Pavarur"	Minutazhi i konsumuar	Deputetë jashtë grupeve parlamentare	Minutazhi i konsumuar
1.	Antoneta Dhima	5'						
2.								
3.								
4.								

**Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK)”.**

<b>Nr.</b>	<b>Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “Demokrat”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “I Pavarur”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Deputetë jashtë grupeve parlamentare</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>
1.	Elisa Spiropali - <i>Ministër</i>	2’	Myslim Murrizi	10’				
2.								
3.								
4.								

**Çështje jashtë rendit të ditës.**

<b>Nr.</b>	<b>Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Grupi Parlamentar “Demokrat”</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>	<b>Deputetë jashtë grupeve parlamentare</b>	<b>Minutazhi i konsumuar</b>
1.					Kujtim Gjuzi	1’